Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*
- ç *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*
- dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Ne permbushje te kapacitetit ekonomik dhe financiar operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar xhiroja mesatare vjetore, gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit, në një vlerë te pakten prej 1,250,000 (nje milion e dyqind e pesedhete mije) leke.*

Operatorët ekonomik qe kane aktivitet me pak se 3 (tre) vite, duhet te kene xhiro mesatare nga data e zhvillimit te tenderit, ne vleren e kerkuar te pakten prej 1,250,000 (nje milion e dyqind e pesedhete mije) leke.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese vertetim nga institucionet e autorizuar me ligj ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura ose kopje të certifikuara të bilanceve.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit, sherbime te ngjashme me nje vlere prej 500.000 (peseqind mije) Lekë.*

Lidhur me kete pike, kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin

privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimumi 5 (pese) punonjes te pakten per 3 (tre) muajt e fundit.*

Ne lidhje me kete pike ofertuesi duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga institucionet e autorizuar me ligj, ne te cilin te jete i percaktuar numri i punonjesve te pakten per 3 (tre) muajt e fundit.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i regjistruar ne regjistrin publik te shoqerive te eksperteve kontabel te autorizuar (IEKA).*

Ne plotesimin e kesaj pike OE ofertues duhet te paraqese nje vertetim nga IEKA.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:*

- *CV te shoqerise (pershkrim i hollesishem i aktivitetit te shoqerise)*
- *CV te personelit qe do te angazhohet per kryerjen e ketij lloji sherbimi nga te cilet te pakten dy prej tyre duhet te kene kualifikime CPA (Certified Public Accountant, Ekspert Kontabel i Autorizuar) dhe/ose ACCA (Association of Chartered Certified Accountants Shoqata e Eksperteve Kontabel te Autorizuar), ekuivalenti i IEKA-s se Shqiperise.*

Per kete operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese per personelin e kualifikuar, certifikata ose diploma qe vertetojne kualifikimet e kerkuara me siper, si dhe listpagesat, ne te cilat duhet te perfshihen ekspertet e sipercituar te pakten per 3(tre) muajt e fundit.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i njohur nga Banka Boterore (The World Bank).*

Ne lidhje me kete pike duhet te paraqese listen e firmave audituese te Bankes Boterore (Eligible audit firms) ne te cilen duhet te jete i perfshire operotori ekonomik ofertues me statusin Fully Acceptable.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 10

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm)

gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

“Auditimi nga një shoqëri e pavarur audituese i pasqyrave financiare të OST sh.a. për vitin 2019”

Afatet e ekzekutimit:

1 (nje) muaj nga hyrja ne fuqi e kontratës.

Shtojca 11

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË OST sh.a. PËR VITIN USHTRIMOR 2019

Objektivi

Objektivi i auditimit të Pasqyrave Financiare është të mundësojë audituesit të shprehin një opinion profesional mbi pasqyrat financiare të OST sh.a., të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) siç publikohen nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB). Regjistrimet kontabël të OST sh.a. sigurojnë bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe pasqyrojnë transaksionet e tij financiare.

Përgjegjësia e përgatitjes së pasqyrave financiare

OST sh.a., është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë mbajtjen e evidencave përkatëse të kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm, zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël, ruajtjen e aktiveve dhe dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse.

Qëllimi

Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto Standarde kërkojnë që audituesit të planifikojnë dhe kryejnë auditimin duke u siguruar mbi vërtetësinë e pasqyrave financiare. Një auditim përfshin shqyrtimin, në bazë të testimit, të provave që mbështesin vlerat e pasqyruara në pasqyrat financiare. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Audituesi duhet të verifikojë se pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me IFRS. Një paketë e plotë e pasqyrave financiare përmban elementët e mëposhtëm:

- (a) një pasqyrë të pozicionit financiar në fund të periudhës;
- (b) një pasqyrë të fitimit/humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën;
- (c) një pasqyrë të ndryshimeve në kapital për periudhën;
- (d) një pasqyrë të flukseve të mjeteve monetare për periudhën;
- (e) shënime, që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese;

Raportet e Auditimit

Audituesi do të japë një opinion mbi Pasqyrat Financiare të OST sh.a., duke treguar nëse këto Pasqyra Financiare paraqesin me vërtetësi operacionet financiare gjatë vitit ushtrimor që mbyllet me 31.12.2019 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB).

Përvec Raportit të Auditimit mbi Pasqyrat Financiare, audituesi do të përgatisë një “Letër Menaxhimi”, në të cilën do të:

- (a) Japë komente dhe vëzhgime mbi regjistrimet kontabël, metodat dhe kontrollin e OST sh.a., të ekzaminuara përgjatë procesit të auditimit;
- (b) Identifikojë mangësitat kryesore dhe dobësitë në metodat dhe kontrollin dhe të japë rekomandime për përmirësimin e tyre;
- (c) Raportoje për mospajtimin e secilit pakt financiar në marrëveshjet financiare;
- (d) Komunikojë çështje të evidentuara gjatë auditimit që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në operacionet e shoqërisë;
- (e) Evidentoje huamarrësit çdo çështje tjetër që audituesit konsiderojnë me vend;
- (f) Përfshijë komente mbi menaxhimin në Letrën e Menaxhimit.

Nëse nuk përgatitet një letër menaxhimi, auditori do të lëshojë një letër ku thuhet se gjatë auditimit nuk është konstatuar ndonjë rrethane/veprim që auditori konsideron me vend që të silltet në vëmendjen e menaxhimit.

Të gjitha Raportet Përfundimtare të Auditimit dhe Letra e Menaxhimit do të përgatiten në gjuhën shqipe dhe angleze.

Gjithashtu audituesi duhet të përkthejë në anglisht Pasqyrat Financiare, të cilat do përgatiten nga OST sh.a. vetëm në gjuhën shqipe.

Afati

Audituesi ka të drejtë të kryejë teste apo kontrolle, të cilat i shikon si të nevojshme për të arritur qëllimin e auditimit, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Të gjitha Raportet Përfundimtare të Auditimit dhe Letra e Menaxhimit për Pasqyrat Financiare të OST sh.a. për vitin 2019 do të dorëzohen pranë OST sh.a brenda 30 ditëve nga marrja me email e Pasqyrave Financiare të vitit ushtrimor që do të auditohet.

**TERMAT E REFERENCËS
PËR AUDITIMIN E PROJEKTEVE TË OST sh.a. ME BANKËN BOTËRORE
PËR VITIN USHTRIMOR 2019**

Objektivi

Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare të projektit është të mundësojë audituesin të shprehë një opinion profesional mbi pozicionin financiar të projektit në fund të vitit ushtrimor 2019. Regjistrimet kontabël të projektit ofrojnë bazën për përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat pasqyrojnë transaksionet financiare në lidhje me projektin:

- Projekti për Rimëkëmbjen e Energjisë [Kredi e Bankës Botërore]

Përgjegjësia e përgatitjes së pasqyrave financiare

Përgjegjësia e përgatitjes së Pasqyrave Financiare, duke përfshirë dhe notat shpjeguese përkatëse është e manaxhimit të PIU/OST. Si pjesë e procesit të auditimit, audituesi duhet të kërkojë prej manaxhimit konfirmime me shkrim në lidhje me pasqyrimet që i bëhen atij në lidhje me procesin e auditimit.

Qëllimi

Auditimi do të bëhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurimit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), me reference specifike ISA 800 dhe udhëzuesve të Bankës Botërore.

Me qëllim evidentimin e pajtueshmërisë me marrëveshjet e financimit itë projektit të dakorduar, audituesi pritët t'i kushtojë vëmendje të veçantë çështjeve si më poshtë:

- a) Të gjitha fondet e jashtme janë përdorur në përputhje me kushtet e marrëveshjeve përkatëse të financimit, duke i kushtuar vëmendje përdorimit me efikasitet në përputhje me qëllimin për të cilin është siguruar financimi;
- b) Fondet e kundërparti janë siguruar dhe shfrytëzuar në përputhje me marrëveshjet përkatëse të financimit dhe vetëm për qëllimin për të cilin është siguruar financimi;
- c) Mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara janë prokuruar në përputhje me marrëveshjet përkatëse të financimit, duke përfshirë dispozitat specifike të Udhëzuesit të Prokurimeve të Bankës Botërore;
- d) Mbajtja e dokumentave suportuese të nevojshme, regjistrimeve dhe llogarive në përputhje me të gjitha kushtet e projektit, duke përfshirë këtu aplikimet për tërheqje, përdorimet e fondeve të raportuara nëpërmjet Raportit Përmbledhës ose Pasqyrës së Shpenzimeve (SOEs), ose Llogaritë e vecanta. Duhet të pasqyrohen linkime të qarta midis regjistrimeve kontabël dhe aplikimeve për

tërheqje të fondeve të paraqitura Bankës;

Pasqyrat Financiare të Projekteve

Pasqyrat financiare duhet të përfshijnë:

- a. Një Përmbledhje të fondeve të marra, duke evidentuar fondet nga Banka Botërore, fondet e projektit nga donatorë të tjerë, apo fondet kundërparti në mënyrë të vecantë.
- b. Një Përmbledhje të përdorimit të fondeve sipas zërave kryesore të projektit dhe kategorive kryesore të shpenzimeve, si për vitin 2019 ashtu dhe për ato të akumuluar;
- c. Dhënie e informacioneve shtesë në shënime/notat shpjeguese, duke përfshirë detajet e pasqyrave të shpenzimeve (SOE) të cilat kanë shoqëruar aplikimet për tërheqjen e fondeve gjatë periudhës, një rakordim i lëvizjeve të Llogarisë së Vecante dhe një Një bilanc duke treguar fondet e akumuluar të projektit, balancat e bankës, asetet e projektit dhe detyrime nëse ka ndonjë.
- d. Shënime, që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese

Pasqyra e Shpenzimeve

Audituesi duhet të auditojë të gjitha aplikimet për tërheqjet e fondeve të projektit. Shpenzimet duhet të ekzaminohen për përshtatshmërinë bazuar në kriteret e përcaktuara në kushtet e marrëveshjes së financimit si dhe të detajuara në Dokumentin e Vlerësimit të Projektit. Audituesi duhet të raportojë çdo shpenzim të papërshtatshëm të identifikuar të përfshirë në kërkesat e tërheqjes dhe rimbursuar. Audituesi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë nëse:

- a) Raportet përmbledhëse ose SOE janë përgatitur në përputhje me dispozitat e marrëveshjes përkatëse të financimit;
- b) Shpenzimet janë bërë tërësisht dhe domosdoshmërisht për realizimin e objektivave të projektit;
- c) Janë marrë informacione dhe shpjegime të nevojshme për qëllimet e auditimit;
- d) Janë mbajtur regjistrimet dhe dokumentacioni mbështetës i nevojshëm për qëllimin e auditimit;
- e) Raportet Përmbledhëse (ose SOE) janë të besueshme për të suportuar aplikimet përkatëse të tërheqjeve.

Llogaria e Vecantë

Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të projektit, audituesit i kërkohet të shqyrtojnë aktivitetet e llogarisë (ve) të veçanta të projektit. Aktivitetet që do të shqyrtohen do të përfshijnë depozitimet e përfituara, pagesat e bëra, interesat e fituara dhe saldot e mbetura në fund të periudhës.

Audituesi duhet t'i kushtojë vëmendje të vecantë respektimit të procedurave të Bankes dhe balancave të saj në fund të çdo viti fiskal si dhe përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme të këtij tipi të mekanizmit të disbursimeve.

Raportet e Auditimit

Audituesi do të lëshojë një opinion të auditimit për pasqyrat financiare të projektit:

- **Projekti për Rimëkëmbjen e Energjisë, Komponenti 3** [Kredi ref. 8429-AL e Bankës Botërore]

Opinion i audituesit bazohet në një vlerësim të konkluzioneve të nxjerra nga provat e marra gjatë auditimit dhe duhet të shprehet qartë përmes një raporti me shkrim që gjithashtu përshkruan bazën për atë opinion.

Përveç opinionit të auditimit, audituesi do të përgatisë një “Letër Menaxhimi”, në të cilën do të:

- (a) Japë komente dhe vëzhgime për regjistrimet kontabël dhe kontrollet që janë kryer gjatë procesit të auditimit;
- (b) Identifikojë të meta dhe dobësi gjatë kontrollit dhe të rekomandojë për përmirësimin e tyre;
- (c) Raportoje mbi mosrespektimin e përputhjes e kushteve financiare në marrëveshjet përkatëse financiare;
- (d) Përcaktojë vlerën dhe të raportoje shpenzimet që konsiderohen si të papërshtatshme, të cilat mund të jenë paguar nga llogaria e veçantë, ose që pretendohen nga Banka Botërore;
- (e) Komunikojë çështjet që kanë tërhequr vëmendjen gjatë auditimit, të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në zbatimin e projektit;
- (f) Shprehet për huadhënësin për çdo çështje tjetër që audituesi e konsideron të rëndësishme; dhe
- (g) Përfshijë komentet e menaxhimit në “Letrën e Menaxhimit”.

Nëse nuk përgatitet një letër menaxhimi, audituesi do të lëshojë një letër ku thuhet se gjatë auditimit nuk është konstatuar ndonjë rrethane/veprim që audituesi konsideron me vend që të sillet në vëmendjen e huamarrësit.

Raportet përfundimtare të auditimit do të përgatiten në gjuhën angleze. Letra e Menaxhimit duhet të përgatitet në gjuhën shqipe dhe angleze.

Afati

Audituesi ka të drejtë të kryejë teste apo kontrolle, të cilat i shikon si të nevojshme për të arritur qëllimin e auditimit, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Të gjitha Raportet Përfundimtare të Auditimit dhe Letra e Menaxhimit të projektit të Bankës Botërore për vitin ushtrimor 2019 do të dorëzohen pranë OST sh.a brenda 30 diteve nga marrja me email e Pasqyrave Financiare të projektit.

Të përgjithshme

Audituesit do ti jepet akses në të gjitha dokumentat ligjore, korrespondenca, dhe çfaredolloj informacioni tjetër që lidhet me projektin dhe që konsiderohet i nevojshem nga audituesi.

Audituesi mund te kerkoje te marre konfirmim për shumat e disbursuara dhe saldot në Bankë dhe shumat e disbursuara nga donatorë të tjerë, hua ose grante, nëse ka ndonje rast të tillë.

Do të ishte e nevojshme që audituesi të njihet me udhezuesit e Bankës Botërore, të cilat shpjegojne kërkesat e raportimit financiar dhe auditimit të Bankes. Këto udhezues përfshijne:

- Operational Policies OP 10.00 Investment Project Financing; Bank Policy: Program for Results Financing; OP 8.60 Development Policy Lending.
- Disbursement Guidelines for Investment Project Financing , February 2017
- Loan Handbook for World Bank Borrowers (the Loan Handbook), February 2017
- Financial Monitoring Reports for World Bank-Financed Projects: Guidelines for Borrowers, November 2001
- World Bank Procurement Guidelines

Audituesi duhet të kuptojë që dokumentat në lidhje me projektet e Bankës Botërore mund të jenë subjekt i rishikimit nga stafi i Bankes si dhe i publikimit sipas kushteve të marrëveshjeve përkatëse.

**TERMAT E REFERENCËS
PËR AUDITIMIN E PROJEKTEVE TË OST sh.a. ME ME FINANCIM TE HUAJ
PËR VITIN USHTRIMOR 2019**

Objektivi

Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare të projektit është të mundësojë audituesin të shprehë një opinion profesional mbi pozicionin financiar të projektit në fund të vitit ushtrimor 2019. Rregjistrimet kontabël të projektit ofrojnë bazën për përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat pasqyrojnë transaksionet financiare në lidhje me projektin:

- Projekti për Linjën e Qarkut 110 kV Shqipëri e Jugut (Financim i KfW)
- Projekti për Linjën e Transmetimit 400 kV Tiranë – Prishtinë (Financim i KfW)
- Projekti për Programin e Eficencës së Energjisë të Sektorit të Transmetimit (Financim i KfW)
- Projekti për Linjën e Transmetimit 400 kV Shqipëri- Maqedoni (financim i KfW dhe EU-WBIF)

Përgjegjësia e përgatitjes së pasqyrave financiare

Përgjegjësia e përgatitjes së Pasqyrave Financiare, duke përfshirë dhe notat shpjeguese përkatëse është e manaxhimit të PIU/OST. Si pjesë e procesit të auditimit, audituesi duhet të kërkojë prej manaxhimit konfirmime me shkrim në lidhje me pasqyrimet që i bëhen atij në lidhje me procesin e auditimit.

Qëllimi

Auditimi do të bëhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurimit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), me reference specifike ISA 800.

Me qëllim evidentimin e përputhshmërisë me marrëveshjet e financimit të projekteve të dakorduara, audituesi pritet t'i kushtojë vëmendje të veçantë çështjeve si më poshtë:

- a) Të gjitha fondet e jashtme janë përdorur në përputhje me kushtet e marrëveshjeve përkatëse të financimit, duke i kushtuar vëmendje përdorimit me efikasitet në përputhje me qëllimin për të cilin është siguruar financimi;
- b) Fondet e kundërparti janë siguruar dhe shfrytëzuar në përputhje me marrëveshjet përkatëse të financimit dhe vetëm për qëllimin për të cilin është siguruar financimi;
- c) Mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara janë prokuruar në përputhje me marrëveshjet përkatëse të financimit;
- d) Mbajtja e dokumentave suportuese të nevojshme, regjistrimeve dhe llogarive është në përputhje

me të gjitha kushtet e projektit. Duhet të pasqyrohen linkime të qarta midis regjistrimeve kontabël dhe aplikimeve për tërheqje të fondeve të paraqitura Bankës;

- e) Pasqyrat Financiare duhet të jenë përgatitur në përputhje me parimet e përgjithshme të pranura të kontabilitetit dhe praktikat e udhëzimit përkatëse të Bankës dhe të pasqyrojnë një pamje të vërtetë dhe reale të pozicionit financiar të projektit më 31.12.2019 dhe mbi burimet dhe përdorimet për vitin fiskal 2019;
- f) Rishikimi i përputhjes, plotësimit të kushteve financiare të specifikuara në marreveshjet e huave

Pasqyrat Financiare të Projekteve

Pasqyrat financiare duhet të përfshijnë:

- a) Një Përmbledhje të fondeve të përdorura të projektit, apo fondet kundërparti në mënyrë të vecantë.
- b) Një Përmbledhje të shpenzimeve sipas zërave kryesore të projektit dhe kategorive kryesore të shpenzimeve, si për vitin 2019 ashtu dhe për ato të akumuluar;
- c) Një bilanc duke treguar fondet e akumuluar të projektit, balancat e bankës, asete të projektit dhe detyrime nëse ka ndonjë.
- d) Shënime, që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese

Pasqyra e Shpenzimeve

Audituesi duhet të auditojë të gjitha aplikimet e tërheqjeve për disbursime. Shpenzimet duhet të ekzaminohen për përshtatshmërinë bazuar në kriteret e përcaktuara në kushtet e marrëveshjes së financimit dhe në Dokumentin e Vlerësimit të Projektit. Audituesi duhet të raportojë çdo shpenzim të papërshtatshëm të identifikuar të përfshirë në kërkesat e tërheqjes dhe të rimbursohet. Audituesi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë nëse:

- a) Shpenzimet janë bërë tërësisht dhe domosdoshmërisht për realizimin e objektivave të projektit;
- b) Janë marrë informacione dhe shpjegime të nevojshme për qëllimet e auditimit;
- c) Janë mbajtur regjistrimet dhe dokumentacioni mbështetës i nevojshëm për qëllimin e auditimit;

Raportet e Auditimit

Audituesi do të lëshojë një opinion të auditimit për pasqyrat financiare të projektit:

- Projekti për Linjën e Qarkut 110 kV Shqipëri e Jugut (Financim i KfW)
- Projekti për Linjën e Transmetimit 400 kV Tiranë – Prishtinë (Financim i KfW)
- Projekti për Programin e Eficencës së Energjisë të Sektorit të Transmetimit (Financim i KfW)
- Projekti për Linjën e Transmetimit 400 kV Shqipëri- Maqedoni (financim i KfW dhe EU-WBIF)

Opinionin e audituesit bazohet në një vlerësim të konkluzioneve të nxjerra nga provat e marra gjatë auditimit dhe duhet të shprehet qartë përmes një raporti me shkrim që gjithashtu përshkruan bazën për atë opinion. Përveç opinionit të auditimit, audituesi do të përgatisë një “Letër Menaxhimi”, në të cilën do të:

- a) Japë komente dhe vëzhgime për regjistrimet kontabël dhe kontrollet që janë kryer gjatë procesit të auditimit;
- b) Identifikojë të meta dhe dobësi gjatë kontrollit dhe të rekomandojë për përmirësimin e tyre;
- c) Raportoje mbi mosrespektimin e përputhjes e kushteve financiare në marrëveshjet përkatëse financiare;
- d) Komunikojë çështjet që kanë tërhequr vëmendjen gjatë auditimit, të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në zbatimin e projektit;
- e) Shprehet për huadhënësin për çdo çështje tjetër që audituesi e konsideron të rëndësishme; dhe
- f) Përfshijë komentet e menaxhimit në “Letrën e Menaxhimit”.

Nëse nuk përgatitet një letër menaxhimi, audituesi do të lëshojë një letër ku thuhet se gjatë auditimit nuk është konstatuar ndonjë rrethane/veprim që audituesi konsideron me vend që të sillet në vëmendjen e huamarrësit.

Raportet përfundimtare të auditimit do të përgatiten në gjuhën angleze. Letra e Menaxhimit duhet të përgatiten në gjuhën shqipe dhe angleze.

Afati

Audituesi ka të drejtë të kryejë teste apo kontrolle, të cilat i shikon si të nevojshme për të arritur qëllimin e auditimit, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Të gjitha Raportet Përfundimtare të Auditimit dhe Letra e Menaxhimit të projekteve me financim të huaj për vitin ushtrimor 2019 do të dorëzohen pranë OST sh.a. brenda 30 diteve nga marrja me email e Pasqyrave Financiare të projektit.

Të përgjithshme

Audituesit do ti jepet akses në të gjitha dokumentat ligjore, korrespondenca, dhe çfaredolloj informacioni

tjetër që lidhet me projektin dhe që konsiderohet i nevojshem nga audituesi.

PIU/OST do të bashkëpunojë plotësisht me audituesin dhe do t’i bëjë të mundur audituesit çfarëdolloj regjistrimi, dokumentacioni dhe informacioni që do të kërkohet nga audituesi në lidhje me procesin e auditimit. Audituesit do ti jepet akses në të gjitha dokumentat ligjore, korrespondenca, dhe çfarëdolloj informacioni tjetër që lidhet me projektin dhe që konsiderohet i nevojshem nga audituesi. Konfirmimi duhet merret gjithashtu për shumat e disbursuara dhe saldot në Bankë dhe shumat e disbursuara nga donatorë të tjerë, hua ose grante, nëse ka ndonje rast të tillë.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:
Zyra Qëndrore e OST Sh.a.

Shtojca 12

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 13

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
2. _____	_____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

KUSHTET E PËRGJITHSHME
Shërbimet –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nenkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nenkontraktuesin një dispozitë që premtëson ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit

